



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.35, datë 26.06.2007

**“PËR MIRATIMIN DHE FINANCIMIN E PROJEKTIT “TË MËSOJMË DUKE VEPRUAR”**

Mbështetur në Ligjin Nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 10, pika II/c, Ligjit Nr.9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” neni 6 dhe neni 29, pika 4, si dhe Vendimit të Këshillit bashkiak Nr.23, datë 30.04.2007 “Për miratimin e realizimit të Buxhetit të vitit 2006 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2007”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë projektin: “Të mësojmë duke vepruar”, sipas preventivit bashkëlidhur, pjesë përbërëse e vendimit.
2. Efektet financiare të projektit në shumën 2.522.700 lekë, do të përballohen duke pakësuar në po këtë shumë fondin e miratuar në zërin “Projekte sociale”, miratuar në Buxhetin e Bashkisë së Tiranës për vitin 2007.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen, Drejtoria e Përkujdesit Social, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, Drejtoria e Buxhetit dhe Administrimit Financiar dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SOKOL DERVISHAJ**

**K R Y E T A R**